

Raporti individual i konsultimit publik

1. Titulli i projekt aktit: “Për Policinë e Shtetit”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Ky projektligj është pjesë e korpusit të akteve ligjore e nënligjore të propozuara në kuadër të masave për zbatimin e programit të Qeverisë 2021-2025 dhe prioritetëve në fushën e rendit dhe të sigurisë publike të parashikuara në Kreun “Shqipëria e Sigurtë” të këtij programi. Miratimi i këtij projektligji është parashikuar në programin analitik të akteve, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 790, datë 28.12.2023 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projekt akteve që do të dërgohen për shqyrtim, në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2024”.

Në dhjetor të 2022, Policia e Shtetit filloi procesin e ndryshimeve në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.

Në bazë të urdhrin nr. 62, datë 28.4.2023 të Ministrit të Brendshëm, “Për ngritjen e grupit për hartimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar”, grupi i punës i përbërë nga anëtarë të Policisë së Shtetit dhe nëpunës të Ministrisë së Brendshme, ka punuar për hartimin e këtij projekti.

Në takimet e grupit të punës ku kanë marrë pjesë edhe organizata partnere, ndërkombëtare, projektligji ka konsideruar dhe reflektuar gjerësisht rekomandimet dhe vlerësimet e organizmave dhe ekspertizës ndërkombëtare/evropiane/rajonale si: rekomandimet e progres raportit të Komisionit Evropian, GRECO-s, OSCE, modelet e standardeve të policimit, transparencës dhe integritetit, efijencës së menaxhimit dhe drejtimit policor, operacionalitetit, modernizimit si dhe aspekte të tjera të shprehura në rekomandimet e ICITAP, EU4LEA, CIDS.

Gjithashtu, projekt akti është publikuar për konsultim në RENJKP përgjatë periudhës 13 mars 2024 deri në 2 prill 2024. Arsyeja kryesore për këtë ndryshim afati lidhet me një problem teknik që u shfaq në sistemin e Regjistrin Elektronik të Njoftimeve për Konsultim Publik. Për shkak të këtij problemi teknik, datat për periudhën e konsultimit u përcaktuan automatikisht, gabimisht nga sistemi, duke rezultuar në një periudhë pak më të shkurtër se ajo e parashikuar me ligj.

Projekti i publikuar në RENJKP, pati 629 lexime, 0 komente në platformë dhe 4 dokumente me komente të dërguara në e-mailin e koordinatorit të sistemit.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroini informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara

të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Për të siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe transparent në hartimin e projektligjit “Për Policinë e Shtetit”, janë përdorur gjashtë metoda të ndryshme konsultimi. Më poshtë gjeni një përshkrim të detajuar për secilën nga këto metoda:

1. Përdorimi i Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet prej datës 13 mars 2024 deri në 2 prill 2024, si një mënyrë e cila lejon qytetarët dhe palët e interesuara të paraqesin komente dhe sugjerime në lidhje me projektligjin përmes internetit, duke siguruar akses të gjerë dhe transparencë në procesin e konsultimit;
2. Takime me grupin e punës në zbatim të urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 62, datë 28.04.2023 “Për ngritjen e grupit për hartimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar””, me përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Ministria e Brendshme. Këto takime përfshijnë mbledhje të grupit të punës të ngritur posaçërisht për hartimin e projektligjit, diskutime të detajuara mbi ndryshimet e propozuara në ligj dhe siguria që të gjitha aspektet e nevojshme janë marrë parasysh. Prej muajit prill 2023 deri në shtator 2023, Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit kanë përgatitur dy projekte me ndryshime për ligjin aktual të policisë, për të vlerësuar mundësinë e ndryshimeve ose hartimin e një ligji të ri. Pas dakordësisë për një ligj të ri, grupi i punës ka kryer takime intensive dhe të përditshme me karakter teknik mbi projektligjin, në ambientet e Ministrisë së Brendshme prej orës 9:00 të paradites deri në përfundim të orarit zyrtar, përgjatë gjithë muajve shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2023, janar, shkurt dhe mars 2024.
3. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike), si formë për të komunikuar me individë dhe organizata të interesuara në lidhje me projektligjin, por gjithashtu edhe për shkëmbime të dokumenteve dhe komenteve midis anëtarëve të grupit të punës dhe titullarëve të institucionit;
4. Marrje e mendimeve të ministrive të linjës në datë 2.4.2024, përmes sistemit të e-akteve, si mënyrë komunikimi dhe koordinimi ndërmjet ministrive për të siguruar që të gjitha aspektet ligjore dhe të politikave janë përfshirë. Pas marrjes së mendimeve dhe reflektimit të tyre në tekstin e projektligjit nga grupi i punës, akti është rihedhur për bashkërendim në sistem në datë 11.6.2024. Pasi u mor dakordësia e ministrive, akti ka kaluar për miratim në Këshillin e Ministrave. Pas komenteve të marra edhe nga drejtoritë teknike në Kryeministri, akti u rihodh në sistem për miratim përfundimtar në datë 24.6.2024, duke marrë statusin “i kompletuar”;
5. Tryeza diskutimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me Drejtoritë Vendore të Policive, në çdo qark, përgjatë muajve shkurt-mars 2024, ku u mundësua diskutimi direkt me personelin policor në terren për të marrë mendimet dhe sugjerimet e tyre mbi ndryshimet e propozuara dhe për të siguruar që ato reflektojnë nevojat dhe realitetet e punës së tyre;
6. Ftesë e dërguar nga Ministri i Brendshëm, nëpërmjet shkresës nr. 3423 prot., datë 25.03.2024, drejtuar 25 organizatave të shoqërisë civile për të marrë pjesë në procesin e konsultimit të aktit, si më poshtë:

1. Komitetit Shqiptar të Helsinkit;

2. Institutit të Studimeve Politike (ISP);
3. Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare;
4. Qendrës Europiane;
5. European Movement Albania;
6. Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim;
7. Fondacionit "Shoqëria e Hapur për Shqipërinë";
8. Civil Rights Defenders;
9. Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara;
10. Institutit Shqiptar për Zhvillim Politikash;
11. Institutit për Kontratën Shoqërore (SCI);
12. Qendrës Res-Publica;
13. Fondacionit "Së Bashku";
14. Qendrës për Progres dhe Civilizim;
15. Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve CRCA;
16. Qendrës "Alert";
17. Qendrës Altri;
18. Institutit Shqiptar për Çështje Publike - AIPA;
19. Organizatës "Qëndresa Qytetare";
20. Këshillit Shqiptar të Medias;
21. Institutit Shqiptar të Medias;
22. Unionit të Gazetarëve Shqiptarë;
23. Balkan Investigative Reporting Netëork Albania;
24. Organizatës Faktoje;
25. Qendrës Shqiptare për Gazetari Cilësore.

Gjithashtu, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, i dërgoi nëpërmjet postës elektronike një ftesë për pjesëmarrje në tryezën e konsultimit të projektligjit "Për Policinë e Shtetit", në datë 12 prill 2024, në ora 10:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, të gjitha organizatatave të cituara më sipër.

Kësaj ftese iu përgjigjën vetëm dy organizata të cilat u pritën nga Sekretari i Përgjithshëm, Zv. Ministri i Brendshëm në cilësinë e kryetarit të grupit të punës, Drejtori i Drejtorisë së Politikave të Rendit dhe Sigurisë Publike në MB dhe Drejtori i autorizuar i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore Për Çështjet e Brendshme në MB;
- Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB;
- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Rendit, Sigurisë Publike dhe Çështjeve Vendore;
- Drejtoria e Politikave të Rendit dhe Sigurisë Publike;
- Ekspertët e organizatave ndërkombëtare në fushën e policimit, rendit dhe sigurisë publike;

- Koordinator për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJKP.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Në pikën 2 të nenit 56 "Emërimi, lirimi dhe shkarkimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit"	Në pikën 2 të nenit 56 "Emërimi, lirimi dhe shkarkimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit fjalë e fundit të ndryshohet si më poshtë: "Në përbërje të Komisionit ad-hoc përfshihen si anëtarë edhe përfaqësues të institucioneve të pavarura të drejtësisë, akademia dhe shoqëria civile. Rregullat e funksionimit të Komisionit përcaktohen në Rregulloren e Policisë së Shtetit. Ky sugjerim vjen për të qartësuar përbërjen e Komisionit ad hoc të vlerësimit, i cili ngrihet me urdhër të ministrit të Brendshëm me qëllim për të garantuar një komision të pavarur dhe një vendimmarrje meritokratike dhe objektive. Rasti i	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)	I refuzuar	Në lidhje me komentet e IDM për procedurat e emërimit, lirimit dhe shkarkimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit në projektligj është parashikuar se, Ministri i propozon Këshillit të Ministrave kandidatin për Drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit pas kryerjes së një procesi të konkurrimit të hapur, të bazuar në parimet e mundësive të barabarta, meritokracisë dhe mosdiskriminimit. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatit për

	Kosovës, për përbërjen e këtij Komisioni për vlerësimin e kandidatave për Drejtorin e Përgjithshëm të PSH do të ishte një praktikë e mirë për t'u marrë në konsideratë.			drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit përcaktohen me udhëzim të ministrit, duke qenë se ai është edhe autoriteti për propozimin e kandidatit për Drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
Në pikën 4 të nenit 126 "Bashkëpunimi me komunitetin, shoqërinë civile dhe institucionet shtetërore"	Sugjerojmë pas togfjalëshit "me institucionet e administratës shtetërore" të shtohet togfjalëshi "institucione arsimore". Ky sugjerim vjen për faktin se institucionet arsimore janë aktorë të rëndësishëm bashkëpunimi në mënyrë të veçantë në iniciativat e përbashkëta të interesave të komunitetit apo policimit në shkollë.	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)	I refuzuar	Bashkëpunimi me institucionet arsimore ky koment nuk është konsideruar pasi tashmë kjo është një praktikë e konsoliduar prej shumë vitesh dhe veçanërisht me oficerët e sigurisë në shkollë, si edhe është pjesë e konceptit të policimit në komunitet.
Pika 1 të nenit 127 "Bashkëpunimi me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore"	Pas pikës 1 të nenit 127 "Bashkëpunimi me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore" të shtohet pika 2 me përmbajtjen si vijon: "Strukturat e policisë luajnë rol proaktiv në Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP) dhe synojnë: a) të vlerësojnë KVSP si instrument për	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)	I refuzuar	Mbi përfshirjen e rolit aktiv të Policisë së Shtetit në Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike, ky koment nuk është konsideruar pasi theksojmë se me ndryshimet ligjore dhe veçanërisht kompetencave të Prefektit të

	ndërtimin e partneriteteve horizontale me të gjithë strukturat e qeverisjes vendore, si kundër edhe me komunitet e shkollave, biznesin, shoqërinë civile, median e grupe të tjera interesi. b) të hartojnë dhe zbatojnë punën për parandalimin e krimit në kuadër të planit shumë aktorial vendor. Ky plan miratohet në mbledhjet e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike dhe raportohet çdo gjashtë muaj në lidhje me punën për zbatimin e tij. Raporte të ndryshme, përfshirë edhe qëndrime të vetë drejtuesve të policisë në nivel vendor evidentojnë se deri më sot Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike janë instrumente që varen kryesisht nga Kryetari i Bashkisë dhe se drejtuesit e policisë marrin pjesë sa herë që thirren në takim nga drejtuesi i bashkisë. Kjo situatë duhet të ndryshojë sepse ka shumë arsye që policia duhet të ndërtojë punën e saj parandaluese përmes një roli aktiv në KVSP. KVSP si strukturë këshillimore shumaktoriale krijon			Qarkut ky aspekt është tashmë i rregulluar qartësisht në legjislacionin dhe kuadrin nënligjor për KVSP-të dhe Këshillin Kombëtar për Sigurinë në Komunitet.
--	---	--	--	--

	mundësinë për partneritete, bashkëpunime dhe ndërveprime duke e bërë policimin në komunitet një qasje shumë më funksionale se çka qenë deri më sot. Përcaktimet e mëposhtme e bëjnë strukturën vendore të policisë, bashkinë dhe institucione të tjera ligjzbatuese partnere të rëndësishëm në realizimin e misionit të tyre për parandalimin e krimit në nivel vendor. Duke marrë në konsideratë sa më sipër nga njëra anë dhe qasja rregullatore (që tashmë është iniciuar me miratimin në Kuvend amendimeve të Ligjit të Prefektit) nga ana tjetër, bëjnë të mundur dhe qartësojnë rolin aktiv të policisë së shtetit në nivel vendor.			
Pas pikës 3 të nenit 130 "Vlerësimi i performacës së strukturave të Policisë së Shtetit", të shtohet gërma e)	të shtohet gërma e) me përmbajtjen si më poshtë: e) "të vlerësohet risku i integritetit institucional me qëllim adresimin e tij përmes masave për përforcimin institucional në kuadër të luftës efektive kundër korrupsionit". Sugjerimi për përfshirjen e këtij synimi në këtë nen, në	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)	Pranuar pjesërisht	Në lidhje me përfshirjen e riskut të integritetit institucional me qëllim adresimin e tij përmes masave për përforcimin institucional në kuadër të luftës efektive kundër korrupsionit, projektligji ka përfshirë në

	kuadër të vlerësimit të performancës për strukturat policore, ndërmerret me qëllim zbatimin e parimit të "zero tolerancë ndaj korrupsionit dhe ruajtjen dhe përmirësimin e integritetit të punonjësve në të strukturave të Policisë së Shtetit. Integriteti i lartë policor është baza për krijimin e respektit dhe besimit të ndërsjellë midis qytetarëve dhe policisë dhe luan një rol të madh në luftën efektive kundër krimit dhe korrupsionit.			tërësinë e tij një kujdes të veçantë për shmangien e korrupsionit duke krijuar mekanizma të reduktimit të konfliktit të interesit, detyrimeve të punonjësit të policisë si edhe ka miratuar një plan masash të dedikuar në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2022-2024.
Sugjerime për nenet: 56, 65, 74, 80, 95, 96, 109, 111, 114, 117, 120, 124, 131, të projektligjit	Komente mbi zgjedhjen Dr. të Përgjithshëm të Policisë, Kategoritë e pranimit në rolet policore, Formimin e detyrueshëm në shërbim të punonjësit të policisë, Emërtimi i gradave, Pjesëmarrja në veprimtari politike, greva dhe sindikata, Konflikti i interesit, Trajtimi financiar pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punë, Trajtimi i familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës, Ndërprerja e marrëdhënieve të punës të punonjësit të policisë, Rikthimi në	Sindikata e Policisë së Shtetit	Pranuar pjesërisht	Në lidhje me komentet e Sindikatës së Policisë ato janë vlerësuar në raport me komentet e ministrive të linjës për të njëjtat çështje, mundësitë buxhetore dhe problematikat e identifikuara nga Policia e Shtetit. Për sa më sipër, ligji ka krijuar mekanizma mbështetje për punonjësit e policisë si në mbështetjen e ecurisë në karrierë ashtu,

	Polici, Shkeljet e disiplinës, Vlersimi i performancës së punonjësit të policisë, Vlerësimi i Performancës së Strukturave të Policisë së Shtetit - janë bërë ndërhyrje teknike në këto nene si më lart.			motivimit profesional edhe në trajtimin e veçantë financiar gjatë dhe pas shkëputjes së marrëdhënieve të punës por nga ana tjetër në përgjigje të rekomandimeve dhe përafrimit me standardet e vendeve të rajonit dhe Bashkimit Evropian ose të parterëve ndërkombëtarë janë parashikuar edhe kufizime apo kërkesat e nevojshme për garantimin e integritetit dhe profesionalizmit në përmbushjen e funksioneve të Policisë së Shtetit (si kufizimi i aktiviteteve private në konflikt me detyrën, trajnimi i detyrueshëm etj.), të cilat në çdo rast i përgjigjen edhe nevojave të Policisë së Shtetit në menaxhimin efektiv dhe funksional të kapaciteteve të saj.
Komente të përgjithshme mbi modelin dhe	Dokumenti ëord 13 faqe, përgjithësisht bën analizë të ligjit,	Z. Bajram Yzeiraj	Refuzuar	Në lidhje me komentet e Z. Yzeiraj janë

përmbajtjen e ligjit, strukturën e tij, dispozitat e përgjithshme, kreun e II-të të projektligjit, kreun e III-të, kreun IV dhe V, VI, VII, VIII, X, XIII, XVI,	nuk propozon ndërhyrje konkrete në nene specifike. Përmbledhur si më poshtë: Modeli dhe Përmbajtja e Ligjit: Modelet e ligjeve përëndimore dhe ligji shqiptar rregullojnë ndërtimin dhe funksionimin e institucioneve policore. Ligjet duhet të përfshijnë misionin, përgjegjësitë, detyrat, organizimin dhe të drejtat e policisë. Ndryshimet që detajojnë procedurat në ligj janë të gabuara dhe rrezikojnë fleksibilitetin e nevojshëm për situatat e ndryshme. Struktura e Ligjit: Struktura aktuale e ligjit nuk ndjek logjikën dhe teknikën legjislative të duhur. Pas dispozitave të përgjithshme, duhet të vendosen përgjegjësitë institucionale dhe detyrat e policisë, organizimi dhe autoritetet. Dispozitat e Përgjithshme: Objektivat dhe qëllimet e ligjit janë jo të plota. Parimet e veprimtarisë duhet të jenë më të			konsideruar ato që lidhen me policimin demokratik dhe saktësime të terminologjisë së përdorur në projektligj. Sa i përket veprimeve të procedurës penale ato krijojnë mbivendosje me parashikimet në Kodin e Procedurës Penale dhe sipas teknikës legjislative për sa kohë nuk sjellin rregullime më të detajuara nuk mund të krijojnë përsëritje të panevojshme dhe shpesh herë të japin një kuptim të paqartë të veprimeve policore në kuptim të këtij ligji në kontrast me ato të në kuadër të procesit procesit procedural hetimor.
--	---	--	--	--

	qarta dhe të redaktuara saktësisht. Përkufizimet duhet të vendosen në fund të dispozitave të përgjithshme. Kompetencat dhe Masat: Kompetencat duhet të përfshijnë të drejtat administrative dhe ato të policisë gjyqësore në mënyrë të harmonizuar. Detajimi i veprimeve të punonjësve në ligj është i gabuar dhe i bën ligjin të ngjasojë më shumë me një rregullore. Organizimi Struktural: Organizimi duhet të bëhet mbi bazë të përgjegjësive dhe kompetencave, jo thjesht mbi bazë shërbimi. Përgjegjësitë e Autoriteteve: Përgjegjësitë e ministrit duhet të renditen sipas rëndësisë dhe të përfshijnë hartimin e politikave të sigurisë. Pranimi dhe Kariera: Ligji duhet të përcaktojë qartë përgjegjësitë për pranimin në polici dhe të sigurojë mundësi karriere për të gjithë punonjësit. Të Drejtat dhe Detyrimet:			
--	--	--	--	--

	Kreu që trajton të drejtat dhe detyrimet e punonjësve duhet të përqendrohet në trajtimin dhe përfitimet e tyre. Strukturimi i Sistemit të Sigurisë: Nevojitet një rishikim i sistemit të sigurisë për të përfshirë të gjitha organet dhe për të siguruar bashkëpunimin e tyre. Duhet krijuar një komitet ose agjensi kombëtare për sigurinë që analizon kërcënimet dhe formulon strategjitë e sigurisë. Përmirësimet dhe Rekomandimet: Të kryhen studime të thella dhe planifikime për zhvillimin e standarteve të policisë. Të sigurohen burime të duhura dhe të vendosen instrumenta të matjes dhe vlerësimit të performancës. Të ndryshohet filozofia e menaxhimit dhe të forcohet transparenca me publikun.			
Sugjerime mbi rishikimin e nenit 8/c, nenit 122, dhe nenit 127/b të projektligjit.	Policimi në Komunitet (PK): PK është një mjet strategjik për mbajtjen e rendit, jo një fushë veprimtarie. Duhet të përfshijë kujdesin ndaj viktimave, matjen e	Z. Robert Korkuti - punonjës i Policisë së Shtetit (PSH) dhe ekspert/drejtues i disa	Refuzuar	Në lidhje me parashikimin e strategjisë së policimit në komunitet sqarojmë se dokumentat strategjik ndjekin një tjetër kuadër

	kënaqësisë së publikut dhe komunikimin e gjërë me komunitetin. Projektligji i ri: Nuk përfshin obligimin për hartimin e strategjive vjetore të PK, duke e konsideruar si një hap mbrapa në drejtim të policimit demokratik. Sugjerohet rishikimi i Nenit 127/b për të përfshirë bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe hartimin e strategjive vjetore për PK. Rekomandime: PK të mbetet një komponent kyç në ligjin e policisë dhe të përfshijë bashkëpunimin me aktorë lokalë si bashkitë, prefekturat, arsimin, shëndetësinë dhe shoqërinë civile.	projekteve të asistencës ndërkombëtare		ombrellë për hartimin dhe miratimin e tyre dhe parashikimi i konceptit të policimit në komunitet në projektligj është një garanci e mjaftueshme për të zhvilluar politikat dhe kapacitetet në këtë kuadër e veçanërisht s ai përket bashkëpunimit. Detyrimi i hartimit të një dokumenti strategjik në projektligj është kufizuese për natyrën e dokumentit strategjik që do të duhet të hartohet dhe shtrirjes së tij. Në lidhje me çështjen e rolit të Policisë së Shtetit në Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike, në kuadër të rolit të saj në partneritetin në nivel vendor, ky koment nuk është konsideruar pasi theksojmë se me ndryshimet ligjore dhe veçanërisht kompetencave të Prefektit të Qarkut ky aspekt
--	--	--	--	--

				është tashmë i rregulluar qartësisht në legjislacionin dhe kuadrin nënligjor për KVSP-të dhe Këshillin Kombëtar për Sigurinë në Komunitet. Në lidhje me përfshirjen e riskut të integritetit institucional me qëllim adresimin e tij përmes masave për përforcimin institucional në kuadër të luftës efektive kundër korrupsionit, projektligji ka përfshirë në tërësinë e tij një kujdes të veçantë për shmangien e korrupsionit duke krijuar mekanizma të reduktimit të konfliktit të interesit, detyrimeve të punonjësit të policisë si edhe ka miratuar një plan masash të dedikuar në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2022-2024.
--	--	--	--	---

